

V E N D I M
Nr. 355, datë 28.7.1999

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “SHQIPËRIA 2000” PËRREHABILITIMIN E
INSTITUCIONEVE ARSIMORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe në kuadrin e kredisë së dhënë nga Qeveria Greke, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe të Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e projektit “Shqipëria 2000” për rehabilitimin e institucioneve arsimore.
2. Nga 1 500 000 000 (një miliard e pesëqind milionë) dhrahmi, të dhëna nga kredia greke për infrastrukturën sociale, shumë ekuivalente me 3 000 000 (tri milionë) USD, sipas kursit të ditës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të përdoret për realizimin e projektit “Shqipëria 2000”.
3. Fondi i projektit “Shqipëria 2000” të realizohet nga bashkimi i fondeve 3 000 000 (tri milionë) USD, dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, dhe 3 000 000 (tri milionë) USD, dhënë nga fondacioni “Soros” “Projekti për zhvillimin e arsimit në Shqipëri (AEDP)”.
4. Projekti “Shqipëria 2000”, për rehabilitimin e institucioneve arsimore do të zbatohet nga fondacioni “Soros” dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me modalitetet e miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 226, datë 11.4.1997, “Tirana 2000”.
5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe Ministria e Financave të kryejnë procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Ka dhe një tabelë

PROJECT SEGMENTAL / SEGMENTIMI I PROJEKTIT

1. GEOGRAPHICAL DISTRIBUTION / SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

District No. Nr. Rrethit	District Rrethi	School units Shkolla	Project no. Nr. i Projektit	Budget Buxheti (USD)
I	SHKODËR	1		320,000
II	DIBËR	1		200,000
III	DURRËS	1		440,000
IV	VLORË	1		620,000
V	SARANDË	1		630,000
VI	KORÇË	1		265,000
VII	MIRDITË	1		65,000
VIII	TEPELENË	2		170,000
IX	GJIROKASTËR	1		430,000
X	DELVINË	1		180,000
XI	TIRANË	1		620,000
XII	BASHKIA TIRANË	10		2,060,000
		22		6,000,000